



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË JUNIKUT PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1	Opinioni i Auditimit.....	3
2	Gjetjet dhe rekomandimet.....	7
3	Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit.....	14
4	Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	17
	Shtojca I: Letër konfirmimi.....	22
	Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesët e tjera të Raportit të Auditimit.....	23

Për: z. Agron Kuçi, Kryetar i Komunës së Junikut

Adresa: Lagjja Qendër, Junik

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Junikut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet¹.

Opinion i kualifikuar për pasqyra financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Junikut, të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes të përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Junikut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion të kualifikuar

Në regjistrin e pasurive mbi 1,000€ në SIMFK, nuk ishin regjistruar 11 pagesa në vlerë 372,880€.

Më gjerësisht shih tek nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit *‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’*. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik

² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar.

Konkluzioni i auditimit për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Junikut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të komunës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i çështjes

Për vëmendjen tuaj, dëshirojmë të theksojmë faktin se Komuna kishte bërë pagesa nga kategoria e Mallrave dhe shërbimeve në bazë të vendimeve gjyqësore, në shumën prej 18,701€ për kompensimin e pagave jubilarë, pagave përcjellëse dhe shpenzimeve tjera të procedurave gjyqësore. Shumat e paguara janë keq klasifikuar për shkak se nuk përkojnë me kategorinë adekuate të shpenzimeve, me ç'rast janë mbivlerësuar shpenzimet në kategorinë e Mallrave dhe shërbimeve dhe për të njëjtën shumë janë nënvlerësuar shpenzimet e pagave.

Pagesat nga kodet e gabuara kanë ndodhur për shkak të mungesës së fondeve buxhetore, të cilat me rastin e ndarjeve buxhetore nga Qeveria, përkatësisht Ministria e Financave, nuk ishin marrë parasysh si detyrime rrjedhëse gjatë vitit dhe rrjedhimisht, nuk ishte ndarë asnjë fond kontigjent për kompensimin e tyre. Thesari kishte ekzekutuar pagesat nga fondet e ndara për kategoritë tjera.

Duke qenë se çështja në fjalë është mjaft e përhapur në shumë organizata buxhetore dhe po përsëritet për vite me radhë, ajo do të trajtohet më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Në lidhje me këtë çështje, për arsyen e lartpërmendur, nuk është modifikuar opinioni i auditimit.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës së Junikut është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës së Junikut është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Junikut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Junikut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë, dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t gjithmonë do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Junikut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë

³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mospajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm Komunës së Junikut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit tonë, ne kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detaje shih kapitullin 4]

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 – Mos regjistrimi i pasurisë

Gjetja Sipas nenit 6.3 të rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK".

Në regjistrin e pasurive mbi 1,000€ në SIMFK kemi vërejtur se 11 pagesa nuk ishin regjistruar, ku vlera totale e tyre ishte 372,880€.

Kjo ka ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme dhe punës me staf të reduktuar për regjistrimin e pasurisë.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurive ndikon në nënvlerësim të regjistrit të pasurive dhe nga kjo rrjedhimisht ndikon që informatat e paraqitura në PVF të mos jenë të sakta.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të siguroj që është bërë regjistrimi i të gjitha pasurive, sipas kërkesave të rregullores për regjistrimin e pasurisë.

2.2 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalitë) në vitin 2020 ishte 245,395€, prej tyre ishin shpenzuar 239,680€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime kontraktuese tjera, karburant, shpenzime të telefonisë mobile, mirëmbajtje të rrugëve, shpenzime për komunalitet. Kemi testuar 26 mostra për teste substanciale si dhe të pajtueshmërisë në vlerë 33,471€.

Çështja B1 – Mangësi në procesin e blerjes/mos zhvillim i procedurave të prokurimit

Gjetja Neni 4 i rregullës financiare nr.01/2013/MF për Shpenzimin e parave publike, përcakton ndër të tjera se - Prokurimi është element thelbësor për shpenzimin e parave publike, përderisa neni 21 i përcakton shpenzimet për të cilat nuk kërkohen prokurime.

Edhe në këtë vit komuna kishte paguar 13 pagesa në vlerë 2,600€ për “shërbime të marketingut” të cilat janë bërë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me një operator ekonomik për afishimin e logos së komunës dhe shfrytëzimin e hapësirës së caktuar emetuese, informuese dhe reklamuese për aktivitetet e komunës në web portal. Marrëveshja ishte lidhur në kohëzgjatje prej 24 muajve, përgjatë periudhës 2019-2021, me çmim të përgjithshëm në vlerë 4,800€ dhe me çmim mujor në vlerë 200€.

Kjo ka ndodhur për arsye të zbatimit të marrëveshjes ekzistuese.

Ndikimi Pagesat përmes kësaj marrëveshje e cila nuk kishte zhvillim të procedurave të prokurimit me rastin e përzgjedhjes së operatorit ekonomik është në kundërshtim me kornizën ligjore dhe reflekton negativisht në menaxhimin efikas të parave publike.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të siguroj përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur me planifikimin dhe shpenzimin e drejtë të parave publike sipas kritereve të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe kornizës ligjore.

2.2.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 556,470€, prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 474,585€. Ato kanë të bëjnë me mirëmbajtjen investive, ndërtesat administrative, pajisje tjera, asfaltim të rrugëve, kanalizimi etj. Kemi testuar 19 mostra për teste substanciale si dhe të pajtueshmërisë në vlerë 436,070€ si dhe 4 procedura të prokurimit.

Çështja A2- Nënshkrimi i kontratave përtej vlerës së parashikuar të buxhetit

Gjetja Sipas LPP-së Neni 9, pika 3 - Nëse autoriteti kontraktues është organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale. ZKF do të siguroj që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore, ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet e ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla.

Gjatë testimit në dy raste kemi identifikuar që komuna kishte mangësi si në vijim:

- Bashkëfinancimi me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për projektin “Ndërtimi i qendrës për kulturë, turizëm dhe agrobiznes” – vlera e parashikuar ishte 165,000€, prej të cilave MAPL do të financonte vlerën 65,000€ ndërsa komuna e Junikut vlerën 100,000€. Ndërsa kontrata ishte nënshkruar në vlerë 777,777€ me një diferencë prej 612,777€, më të lartë së vlera e planifikuar; dhe
- Bashkëfinancimi me Ministrinë e Infrastrukturës (MI) për projektin “Ndërtimi i rrugës Junik –Gjeravicë” – vlera e buxhetuar për tre vite ishte 2,059,426€, aq sa edhe ishte nënshkruar në disponueshmërinë e mjeteve nga MI ndërsa kontrata ishte nënshkruar në vlerë 4,416,860€ me një diferencë prej 2,357,434€, më të lartë së vlera e buxhetuar.

Mangësitë e përmendura më lartë kanë ndodhur si pasojë e planifikimit jo të mirë të projekteve.

Ndikimi Hyrja në obligime kontraktuale nga komuna përtej mundësive buxhetore dhe në kundërshtim me ligjin, mund të ndikojë dhe rrezikojë mbarëvajtjen dhe implementimin e projekteve sipas planifikimeve si dhe mund të krijoj kosto shtesë për komunën, duke e futur komunën në vështirësi të thella në përmbushjen e obligimeve të krijuara.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të siguroj se do të aplikohen në mënyrë strikte kërkesat ligjore në mënyrë që nënshkrimi i kontratave të bëhet në përputhje me buxhetin e planifikuar dhe aprovuar, në mënyrë që implementimi i projekteve të realizohet në kohë, dhe pa shpenzime shtesë

2.2.3 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me kategori ekonomike si psh: mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja B2 – Zotimi dhe urdhërblerja me vonesë

Gjetja Rregulla financiare Nr.01/2013, neni 22, përcakton hapat për procedim të pagesave, ku fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje (zotimi i mjeteve), të procedohet urdhërblerja, pastaj pranimi i mallit, pastaj pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Gjatë testimi të pagesave kemi vërejtur që zotimi dhe urdhërblerja ishin lëshuar pas pranimit të faturave. Këto raste janë si më poshtë:

- Në 15 raste zotimi i mjeteve dhe procedimi i urdhërblërjeve ishte bërë pas pranimit të faturës; dhe
- Në 5 raste urdhërblerja ishte lëshuar pas pranimit të faturës.

Kjo ka ndodh si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin e menaxhimit dhe ekzekutimit të pagesave.

Ndikimi Zotimi i mjeteve financiare dhe procedimi i urdhërblërjeve me vonesë vështirëson zbatimin e drejtë të kontratave dhe krijon paqartësi rreth urdhërësive për furnizim, shërbime apo fillim të punëve.

Rekomandimi B2 Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet në harmoni me rregullat financiare për shpenzimin e parave publike.

2.2.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 3,973,587€, pasurive jokapitale është 42,942€, ndërsa stoqet ishin zero. Kemi testuar 19 mostra për teste substanciale si dhe të pajtueshmërisë në vlerë 442,597€.

Çështja B3 – Mangësi në regjistrat e pasurisë

Gjetja Sipas rregullores për menaxhimin e pasurisë jofinanciare Nr.03/2013 neni 6 çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jofinanciare që i ka në menaxhim të saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Sipas nenit 22 pika 1 - zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtvizore.

Dobësitë e identifikuara lidhur me menaxhimin e pasurive janë si në vijim:

- Komuna ende nuk ka larguar nga regjistri i pasurive kapitale veturat e shitura në vitin 2019 me ankand publik të cilat ishin jashtë përdorimit; dhe
- Në sistemin e-pasuria nuk është bërë llogaritja e shpenzimeve të zhvlerësimit dhe zhvlerësimit të akumuluar për pasurinë jokapitale.

Përkundër rekomandimit nga viti i kaluar kjo çështje vazhdon të mbetet e njëjtë, komuna ende nuk kishte funksionalizuar kontrollet për menaxhimin e pasurisë.

Ndikimi Mos azhurnimi i regjistrave si dhe mos zhvlerësimi i pasurive ndikon në mbivlerësim/nënvlerësim të regjistrat të pasurive dhe nga kjo rrjedhimisht ndikon që informatat e paraqitura në PVF të mos jenë të sakta.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të siguroj që është bërë azhurnimi i regjistrave të pasurisë kapitale si dhe përlllogaritja e zhvlerësimit për pasurinë jokapitale.

2.2.5 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2020, ishte 11,507€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2021.

Çështja B4 - Vonesë në pagesën e detyrimeve

Neni 37 pika 1 i Rregullës Financiare 01/2013 MF, përcakton se të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve në qoftë se nuk është paraparë ndryshe me kontratë

Komuna e Junikut kishte raportuar çdo muaj në MF për obligimet e papaguara. Mirëpo gjatë auditimit kemi në 6 pagesa në vlerë 58,479€ kishte vonesë në pagesë nga 4 deri 105 ditë, pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh.

Kjo ka ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme dhe punës me staf esencial.

Ndikimi Vonesat në pagesën e obligimeve rrisin rrezikun për kosto shtesë buxhetore në rast të padive nga kreditorët për mos përmbushje me kohë të detyrimit për pagesë.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të siguroj funksionimin efikas të pikës së kontrollit që verifikon se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me ligj.

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	1,627,946	2,011,711	1,924,110	1,883,773	2,082,278
Grante Qeveritare – Buxheti	1,490,747	1,757,788	1,735,090	1,631,395	1,974,583
Financimi përmes huamarrjes	-	19,215	19,215	-	-
Të bartura nga viti i kaluar ⁵ –	-	95,039	94,659	87,612	17,407
Të hyrat vetanake ⁶	137,199	137,199	75,146	91,862	60,851
Donacionet e jashtme	-	2,470	-	72,904	29,437

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 383,765€. Kjo rritje është rezultat i rritjes prej grantit qeveritar 267,041€, huamarrjes 19,215€, të hyrave vetanake nga viti i kaluar 95,039€, dhe donacioneve 2,470€.

Në vitin 2020 Komuna e Junikut ka shpenzuar 96% të buxhetit përfundimtar ose 1,924,110€, me një përqindje të njëjtë me vitin 2019. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2 – Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	1,627,946	2,011,711	1,924,110	1,883,773	2,082,278
Pagat dhe mëditjet	1,141,755	1,169,345	1,169,345	1,110,999	1,085,806
Mallrat dhe Shërbimet	172,899	210,544	207,055	170,608	177,073
Komunalit	36,200	34,851	32,625	29,910	33,005
Subvencionet dhe Transferet	30,500	40,500	40,500	30,500	15,600
Investimet Kapitale	226,889	556,470	474,585	541,756	770,794

⁴ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave


⁵ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁶ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Rezervat	19,703	-	-	-	-
----------	--------	---	---	---	---


Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike

Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike në vitin 2020

Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Rritja e buxhetit të Pagave dhe Mëditjeve në raport me atë fillestar ishte 27,590€. Kjo rritje fillimisht ishte me rishikim buxhetor për 22,365€, ku prej tyre 19,215€ ishin nga Rezerva dhe 3,150€ nga niveli qendror për menaxhimin e emergjencës nga covid-19. Pastaj sipas vendimit Nr. 09/50 të datës 21.12.2020 për kursime, ndarje

dhe rregullime në kategoritë e shpenzimeve, është bërë rritja e kategorisë së pagave në shumë prej 5,225€. Shpenzimi ishte 100% e buxhetit në këtë kategori;

- Te kategoria e mallrave dhe shërbimeve buxheti final ishte rritur në raport me atë fillestar për vlerën 37,645€. Kjo rritje ishte me vendime të Qeverisë, Nr. 01/23 të datës 13.08.2020 dhe Nr. 01/27 të datës 26.08.2020. Në këtë kategori, shpenzimi ishte 98%;
- Buxheti përfundimtar i kategorisë së shërbimeve komunale ishte zvogëluar në raport me buxhetin fillestar për vlerën 1,349€ me vendime të Qeverisë Nr. 09/50 të datës 21.12.2020. Shpenzimi ishte 94% e buxhetit;
- Sa i përket buxhetit përfundimtar të subvencioneve dhe transfereve, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për vlerën 10,000€ me vendim të qeverisë Nr. 01/23 të datës 13.08.2020. Në këtë kategori shpenzimi ishte 100%; dhe
- Rritja në buxhetin e investimeve kapitale në raport me atë fillestar ishte për vlerën 329,581€. Kjo rritje ishte me vendimeve të qeverisë nr. 01/23 te datës 13.08.2020 nga niveli qendror për zbatimin e programit te rimëkëmbjes ekonomike për vlerën 232,090€ dhe bartjes së të hyrave vetanake nga viti i kaluar 95,039€. Shpenzimet në këtë kategori ishin 85% e buxhetit.

Komuna për shpenzimet e ndodhura për menaxhimin e pandemisë COVID 19, kishte shpenzuar 110,094€. Prej tyre nga pagat dhe mëditjet 63,105€, mallrat dhe shërbimet 36,989€ si dhe nga subvencionet 10,000€.

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2020 ishin në vlerë 98,951€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, leje ndërtimore, taksa administrative, nga participimet, nga ushtrimi i veprimtarisë etj.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Të hyrat tatimore	71,356	71,356	61,375	72,283	64,776
Të hyrat jo tatimore	65,843	65,843	37,576	107,533	54,335
Totali	137,199	137,199	98,951	179,816	119,108

Totali i të hyrave të arkëtuara reflekton situatën e krijuar gjatë vitit 2020, ku kemi rënie të mbledhjes së të hyrave në raport me vitin e kaluar dhe vitin paraprak. Në këtë vit të hyrat krahasuar me vitin 2019, ishin më të ulëta për 45% apo për 80,865€.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 ka rezultuar në 13 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit për vitin 2020, 7 rekomandime janë zbatuar; 4 nuk kishte filluar zbatimi si dhe 2 nuk aplikohen më, siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se vendimet do të dërgohen tek palët ankuese brenda afateve ligjore.	Janë ndërmarr veprimet dhe vendimet janë nxjerr me kohë	I zbatuar.
2	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj se tarifa e densitetit do të caktohet sipas kërkesave ligjore në mënyrë të përvitshme dhe se kalkulimi i faturave do të bëhet në mënyrë të saktë.	Nuk ka pasur asnjë rast të tillë në vitin 2020.	I zbatuar.
3	Paga dhe mëditje	Kryetari duhet të sigurojë se nuk pranohet asnjë kërkesë për pushim pa pagesë, nëse në ajo kërkesë nuk përmban qëllimin e shfrytëzimit për këtë lloj të pushimit, si dhe të siguroj se zbatimi i pushimit fillon pas aprovimit të tij.	Pushime pa pagesë të lëshuara për vitin 2020 nuk ka pasur.	I zbatuar.
4	Paga dhe mëditje	Kryetari duhet të sigurojë përmes menaxherit të personelit se proceset e rekrutimit zhvillohen në pajtim të plotë me procedurat dhe rregullat e rekrutimit, dhe në rast të mungesës së tre kandidatëve të përgjegjshëm të rishpallet konkursi.	Në këtë vit nuk janë trajtuar procedurat e rekrutimi sipas metodologjisë së re të auditimit.	Nuk është i aplikueshë m më.
5	Mallra dhe shërbime	Kryetari duhet të rritë kujdesin në procesin e angazhimit të personave me marrëveshje për shërbime të veçanta dhe angazhimet me MSHV të aplikohen vetëm për punë specifike dhe kushte të paparashikuara, gjithmonë duke i zbatuar kërkesat ligjore.	Komuna e Junikut gjatë vitit 2020 kishte 12 marrëveshje për shërbime të veçanta me afat deri me 31.12.2020. Me hyrjen e ligjit për zyrtar publik, këto marrëveshje do të trajtohen sipas procedurave të prokurimit.	Nuk është i aplikueshë m më.

6	Mallra dhe shërbime	Kryetari duhet të siguroj përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur me planifikimin dhe shpenzimin e drejtë të parave publike sipas kriterëve të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe kornizës ligjore.	Komuna edhe këtë vit kishte vazhduar me pagesa sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.	Nuk ka filluar zbatimi.
7	Investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në procesin vlerësimit të drejtë të çmimeve të njëjësive në kuadër të ofertave tenderuese sipas çmimeve të përlogaritura në paramasë, apo edhe manualeve me çmimet referente për njësi të publikuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, çmimeve të tregut dhe çmimeve tjera indikative zyrtare. Kryetari si udhëheqës i ekzekutivit të komunës duhet të siguroj mbikëqyrjen e administrimit financiar të komunës.	Nuk kemi pasur raste të tilla.	I zbatuar.
8	Investime kapitale	Kryetari duhet të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur plotësimin e drejtë të kushteve për pjesëmarrje dhe kriterëve të kërkuara me rastin e nënshkrimit të kontratës.	Nuk kemi pasur raste të tilla.	I zbatuar.
9	Çështje të përbashkëta	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet në harmoni me proceduarat e përcaktuara me LMFPP dhe rregullat financiare për shpenzimin e parave publike.	Edhe në këtë vit kemi identifikuar raste të ngjashme me vitin e kaluar.	Nuk ka filluar zbatimi.

10	Pasuria jofinanciare	Kryetari duhet të siguroj përmes zyrtares së pasurisë azhurnimin e regjistrave të pasurisë kapitale dhe përlogaritjen e zhvlerësimit për pasurinë jokapitale	Komuna ende nuk kishte azhurnuar regjistrat e pasurive si dhe nuk kishte bërë zhvlerësimin e pasurive jo kapitale.	Nuk ka filluar zbatimin.
11	Të Arkëtueshmë	Kryetari duhet të siguroj se procesi i kontrollit në kalkulimin dhe faturimin e taksave është funksionale duke zvogëluar mundësinë gabimeve dhe zbatuar korrigjimet për rastet e identifikuar.	Komuna kishte bërë korrigjimin e tarifës dhe për vitin 2020 nuk kemi identifikuar çështje të tilla.	I zbatuar.
12	Detyrimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet pas sigurimit të mjeteve financiare, gjithashtu duhet të siguroj respektimin e kriterëve ligjore për realizimin pagesave brenda afatit të përcaktuar kohor.	Edhe në këtë vit kemi vërejtur raste të ngjashme.	Nuk ka filluar zbatimin.
13	Funksioni i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të sigurohet nëpërmes komitetet të auditimit se NJAB ofron raporte cilësore ku verifikohen dobësisë ekzistuese dhe ofrohen rekomandime të vlefshëm për pajtueshmëri, përmirësimin e kontrolleve dhe menaxhimin sa më të mirë të parasë publike.	NJAB kishte ndërmarr veprime për përmirësimin e raporteve.	I zbatuar.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2020		
1	Baza për opinion	Kryetari duhet të siguroj që është bërë regjistrimi i të gjitha pasurive, sipas kërkesave të rregullores për regjistrimin e pasurisë.		
2	Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet të siguroj përmirësimin e kontrolleve të brendshme lidhur me planifikimin dhe shpenzimin e drejtë të parave publike sipas kriterëve të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe kornizës ligjore.		

3	Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj se do të aplikohen në mënyrë strikte kërkesat ligjore në mënyrë që nënshkrimi i kontratave të bëhet në përputhje me buxhetin e planifikuar dhe aprovuar, në mënyrë që implementimi i projekteve të realizohet në kohë, dhe pa shpenzime shtesë.
4	Çështjet e përbashkëta	Kryetari të sigurojë përmirësimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që procesi i ekzekutimit të pagesave të bëhet në harmoni me rregullat financiare për shpenzimin e parave publike.
5	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Kryetari duhet të siguroj që është bërë azhurnimi i regjistrave të pasurisë kapitale si dhe përlllogaritja e zhvlerësimit për pasurinë jokapitale.
6	Detyrimet e papaguara	Kryetari duhet të siguroj funksionimin efikas të pikës së kontrollit që verifikon se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me ligj.


Nënshkrimet:

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm

Astrit Bllaca, Udhëheqës i Auditimit

Etika Co shpk, (Fatmir Mehmeti person i autorizuar në emër të kompanisë)

Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së **Junikut**, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe kemi një koment për gjetjen “Mos regjistrimi i pasurisë” e cila ka ndikuar edhe në kualifikimin e opinionit. Në bazë të vendimeve të Qeverisë për pandeminë jemi obliguar të punojmë me staf esencial dhe si pasojë e kësaj zyrtarët përgjegjës nuk kanë mundur që të bëjnë regjistrimin e pasurisë në SIMFK. Ne mendojmë që ky kriter për vitin 2020 nuk duhet të jetë kriter për kualifikim të opinionit duke pasur parasysh gjendjen e krijuar si pasojë e pandemisë; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Agron Kuci

Kryetar i Komunës së Junikut

Data: 06.korrik.2021, Junik,



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesët e tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸. Ky opinion duhet të veçohet nga opinionin nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërteta, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështje (-t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet - në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose jo i modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo te tillë(a) te mundshëm(me) të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Një keq-deklarim është një ndryshim midis shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një artikulli të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që artikulli të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, ose janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, një e vetme ose e agreguar, që nuk është e barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare në tërësi ose keq-deklarimi (-et) dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar të transaksioneve nuk është e barabartë ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të çojë në shmangie të keq-deklarimit (-eve) material (-e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(-ve).

⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë poashtu edhe deklaratat e ekzekutimit të buxhetit

⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë prova të mjaftueshme të auditimit për të konkluduar se pasqyrat financiare në tërësi janë të lira nga keq-deklarimi material.

Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Ndryshimet e opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në provat e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk janë të lira nga keq-deklarimi material dhe/ose mos-pajtueshmëria ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit të mjaftueshëm për të konkluduar se pasqyrat financiare në tërësi janë të lira nga keq-deklarimi material dhe/ose mos-pajtueshmëria, auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit.

Opinionet e modifikuara mund të jenë:

- Të modifikuara (kualifikuara)
- Të kundërta, ose
- Të mohuara

Opinion i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos pajtueshmëri, një e vetme ose një agregat, që është e barabartë ose e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si një e tërë ose kur keq-deklarimi (-et) dhe / ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klasë të caktuar të transaksioneve është i barabartë ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit që nuk mund të çojë në shmangie të keq-deklarimit(-eve) material (-e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, një e vetme ose një agregat, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si një e tërë ose kur keq-deklarimi (-et) dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klasë të caktuar të transaksioneve e tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret në kontekstin e gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive për të përshkruar efektet e gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërinë në pasqyrat financiare ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të gabimeve dhe/ose mos-pajtueshmërinë,

nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë prova të mjaftueshme adekuate të auditimit. Efektet të përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare
- b) Nëse kufizohen kështu, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Në lidhje me shpalosjet, janë thelbësore për kuptimin e pasqyrave financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe e përhapur.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.